



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Të nderuar,

Në vijim të shkresës suaj administruar pranë nesh me Nr.28381 Prot., datë 16.12.2024 ju informojmë se:

Bashkia e Shkodrës, gjatë viteve të fundit i ka kushtuar rëndësi të veçantë çështjeve gjinore dhe dhunës në familje, duke i integruar në të gjitha programet dhe funksionet e saj.

Viktimat e dhunës në familje në Shqipëri mund të kenë akses në disa aplikacione dhe shërbime për t'u ndihmuar. Këto aplikacione janë krijuar për të ofruar mbështetje, informacion, dhe mundësi për të raportuar dhunën dhe kërkuar ndihmë.

Të tilla janë:

- ALO 116111 për fëmijët.
- Bright Sky (Fondacioni Vodafone).
- Policinë e shtetit në numrin falas -112/129;
- Linjën e këshillimit për gra dhe vajza - 116 117;
- Linjën kombëtare të këshillimit- ALO 116 111.

Shërbimet janë të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve dhe organizatave joqeveritare, të cilat punojnë me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

Bashkia Shkodër ka një sërë mënyrash komunikimi :

www.bashkiashkoder.gov.al

shërbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al

fb: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik-Shkodër

ëëë.shkodrarinore.gov.al

fb: Qendra Rinore Atelie

ig: Qendra Rinore Atelie

ig. Qendra Xixëllonjat

Drejtohuni pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen”, në lagjen tuaj ose pranë administratorit tuaj shoqëror!

Nëse po përballeni me dhunë në familje ju mund të telefononi në:

- Policinë e shtetit në numrin falas -112/129;
- Linjën e këshillimit për gra dhe vajza - 116 117;
- Linjën kombëtare të këshillimit- ALO 116 111;
- Gruaja tek Gruaja - 0693310172.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktiviteteesh për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuëse në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore “Atelie” dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri “Migjeni”, Galeria e Arteve, etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

Krahas aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Gjatë aktiviteteve verore të organizuara me fëmijët në qendrat komunitare “Për Familjen” është folur për format e ndryshme të dhunës dhe mënyrat e raportimit të saj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

2. Në zbatim të politikës së zhvillimit: “Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja dhe krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.”, në vitin 2016 Bashkia e Shkodrës ka filluar punën për krijimin e rrjetit të shërbimeve sociale komunitare.

Për herë të parë në vitin 2016 u ngritën **qendrat komunitare “Për Familjen”** të cilat ofrojnë përshtatshmërinë fizike për akses nga i gjithë komuniteti i lagjes.. Këto qendra ofrojnë shërbime sociale si: informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. për të

gjitha kategoritë vulnerabël si: fëmijë, të rinj, persona me aftësi të kufizuara, rom dhe egjiptian, të moshuar etj. Aktualisht janë në funksion të plotë 12 qendra komunitare “Për Familjen”, përkatësisht në 5 lagje të qytetit dhe në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Velipojë, Rrethina dhe Postribë.

Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor është krijuar edhe **Qendra e parë Rinore Publike** dhe **Qendra Multifunksionale “Për Familjen”** në territorin e Bashkisë Shkodër.

Çdo qendër e krijuar dhe e vënë në zbatim nga Bashkia e Shkodrës ka përshtatshmërinë për akses për personat me aftësi të kufizuara: rampa apo ashensor.

Duke u mbështetur në shërbimet ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë duke shtrirë shërbimet në territor, sa më pranë nevojave të komunitetit.

Bashkia Shkodër përveç ofrimit të shërbimeve komunitare, konsideron të rëndësishme krijimin e përshtatshmërisë dhe lehtësirave në komunikim, gjithëpërfshirjen dhe aksesin në shërbime për të gjithë personat me aftësi të kufizuara duke synuar shërbime dhe ambiente publike të mundshme për të gjithë. Me dëshirën për të rritur integrimin e PAK në jetën dhe aktivitetet publike, institucionet publike, si shkollat, biblioteka, qendrat sociale, trotualet, etj. të gjitha projektet e reja infrastrukturore (qendra komunitare, qendra multifunksionale, etj.) dhe rikonstruksionet e godinave ekzistuese të Bashkisë së Shkodrës (biblioteka “Marin Barleti”, shkollat, etj.) janë krijuar me përshtatshmërinë për personat me aftësi ndryshe. Çdo ndërtim i ri dhe çdo rikonstruksion infrastrukturor i realizuar nga Bashkia e Shkodrës ka përshtatshmërinë për akses për PAK (rampa, ashensor, tualete, etj.)

Qendra Rinore Atelie, Qendra Komunitare Multifunksionale “Për Familjen”, Qendra Komunitare “Për Familjen” Rrethina dhe ambientet e shoqatës së Para&Tetraplegjikëve kanë tualete për PAK.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një sërë ndërhyrjesh në **infrastrukturën rrugore** të Bashkisë Shkodër, me qëllim përmirësimin e aksesueshmërisë për PAK, duke ndërtuar një sërë rampash të reja.

Në bashkëpunim me shoqatën e Para Tetraplegjikëve dhe me mbështetjen e UNDP Albania kemi punuar për përmirësimin e **parkingjeve të rezervuar për PAK**, duke synuar pajisjen me një bagde të dedikuar për ta për shfrytëzimin e këtyre hapësirave dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit, si dhe marrjen e masave shtërnguese për ata që bëjnë shkelje duke i përdorur pa të drejtë ato.

Të gjithë **institucionet arsimore të rikonstruktura** kanë përshtatjen e duhur për të siguruar aksesueshmërinë dhe po punohet për përshtatshmërinë në çdo shkollë të qytetit dhe njësive administrative.

Për herë të parë, kemi ndërtuar **parqe publike lojrash** për fëmijët e Bashkisë Shkodër, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Çdo ndërhyrje është realizuar konform standarteve ligjore, përshtatshmërisë dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Në **shkollën speciale “3 Dhjetori”**, një shkollë e dedikuar për fëmijët me AK, përveç procesit mësimor dhe edukativ, ofrohet shërbimi i transportit dhe shërbimi i trajtimit ushqimor për nxënësit që frekuentojnë këtë shkollë. Automjeti që përdoret për transportin e fëmijëve tek shkolla speciale “3 dhjetori” ka përshtatshmërinë e duhur për AK. Në sajë të bashkëpunimit me donatorët shkolla është pajisur me një automjet tjetër të ri, me përshtatshmërinë e duhur për AK.

Në **shkollën “Skënderbeg”** të qytetit të Shkodrës, në bashkëpunim me Eorl Vision është ndërtuar dhe funksionon **“Hapësira Zhvillimore”**. Hapësira zhvillimore është një model inovativ i shërbimeve të integruara, i cili bazohet mbi nevojat e ndryshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve e që nxit partneritetin mes shkollës dhe profesionistëve/ specialistëve për të ofruar shërbime të integruara psiko-sociale, zhvillimore, terapeutike brenda hapësirave shkollore me qëllim zhvillimin e fëmijëve dhe me fokus të veçantë të fëmijët me aftësi të kufizuara.

Është arritur një Marrëveshje Mirëkuptimi mes aktorëve vendorë për administrimin efektiv dhe të qëndrueshëm të këtyre ambjenteve në shkollën “Skënderbeg”, duke u bërë pjesë e 15 shkollave në Shqipëri që krijojnë për herë të parë këto ambjente.

Kemi vënë në funksion Qendrën Harmonia, **qendër, e cila ofron shërbime të specializuara për fëmijët me spektrin autik.**

Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës.

3. Në zbatim të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, ndryshuar me VKM Nr. 327, date 02.06.2021, në Bashkinë e Shkodrës janë të ngritur dhe funksional:

1. Komiteti drejtues, i drejtuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe i përbërë nga drejtuesit e institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel vendor;

2. Ekipi teknik ndërdisiplinor i përbërë nga përfaqësues teknikë të institucioneve pjesë të komitetit drejtues;

3. Koordinator i vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

ETN mbledhet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve, javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mbledhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktima. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mbledhet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë.

Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Për çdo rast të personave të dhunuar ofrohen shërbime parashoqërore (informimi, orientimi, këshillimi, shërbime në familje, mbështetje psiko-sociale dhe ndërhyrje të hershme); shërbime komunitare (mbrojtja e fëmijëve, shërbime për fëmijën dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, shërbime arsimore, lëvizëse, shërbime për higjenën personale, kujdesin shëndetësor); shërbime të strehimit emergjent dhe të përkohshme (strehëz për situatë emergjente dhe banesa sociale). Në varësi të nevojave specifike të rastit, ofrohen edhe shërbimet specifike për të cilat individi ka nevojë.

Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër, duke asistuar që në momentin e nxjerrjes së UMM-së apo UM-së, marrjen pjesë në seancat gjyqësore, përgatitjen e raporteve për vlerësimin e gjendjes social-ekonomike dhe hartimin e dërgimin e raporteve përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër etj.

Të gjithë rastet e dhunës në familje të pajisura me UM, përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Specialistët pranë qendrave komunitare “Për Familjen” informojnë çdo rast të

pajisur me UM për pagesën që me ligj ju takon dhe orientojnë/ asistojnë për procedurën përkatëse që duhet të ndjekin për ta përfutur atë.

Të gjitha rastet janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie në bashkëpunim të ngushtë me disa nga aktorët kryesore të MKR-së si: Policia Vendore e Policisë Shkodër, organizatat e shoqërisë civile (“Gruaja tek gruaja”, “Shpresë për Botën” etj.), Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër dhe NJVKSH Shkodër, në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

Ju lutem bashkangjitur gjeni listëprezencën e takimit të fundit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Benet Beci